

## Për dhëmbë të shëndoshë të qumështit

Që dhëmbi i parë i fëmijës së Juaj është i rrezikuar nga kariesi. Për këtë arsye duhet që dhëmbët e qumështit të mirëmbahen që nga fillimi.

- Që fëmija Juaj të ketë shance për dhëmbë të shëndoshë, do të duhej që vetë Ju prindërit të keni kujdes për dhëmbët e Juaj. Me këtë reduktoni rrezikun e bartjes së bakterieve të kariesit tek fëmija Juaj dhe i shërbeni fëmijës së Juaj si një shembull i mirë.
- Nga këshilltarja për nëna dhe baballarë merrni informacione, udhëzime dhe finesa mbi mirëmbajtjen e dhëmbëve dhe të ushqyerit.
- Në lidhje me pyetjet që kanë të bëjnë me dhëmbët e qumështit keni në dispozicion telefonik edhe Ekipin Profilaksik të Shërbimit Dentar Shkollor („Prophylaxeteam des Schulzahnärztlichen Dienstes“) dhe atë të enjteve në mëngjes mes orës 7.30 dhe 8.30 (telefoni 052 269 10 81) ose përmes e-mailit ([prophylaxe@win.ch](mailto:prophylaxe@win.ch)).
- Përditshmëria me fëmijë të vegjël është ndonjëherë edhe e vështirë. Procedurat e larjes së dhëmbëve dhe të ushqyerit e shëndetshëm mund të jenë shumë të mundimshme. Nëse ndiheni të mbingarkuar në këtë aspekt, mund të merrni ndihmë nga ne. Flisni për këtë problem me këshilltaren për nënat dhe baballarët apo lajmërohuni direkt tek ne..
- Keni drojë se me dhëmbët e fëmijës së Juaj nuk është diç në rregull? Shkoni tek mjekja/mjeku Juaj i dhëmbëve ose lajmërojeni fëmijët e Juaj me kohë për një këshillim falas. (telefoni: 052 269 10 80). Kjo ofertë vlen për fëmijët e moshës 1 deri 4 vjeç.
- I duhet fëmijës së Juaj trajtim për shkak të kariesit? Ne ju këshillojmë për mënyrën e veprimit dhe ju udhëzojmë tek personat profesionistë.

## A ekziston rreziku i shtuar i kariesit tek fëmija im?

**Përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme dhe vlerësoni rrezikun e kariesit të fëmijës së Juaj (nga moshja 12 muajshe):**



Unë nuk i kam pastruar dhëmbët e fëmijëve të mi që nga fillimi...  **e saktë**

Unë nuk përdor pastë dhëmbësh me fluor për fëmijën tim...  **e saktë**

Natën fëmija im pin nga shishja njërën nga këto lëngje:

Ovo/ çoko – qumësht, çaj të ëmbëlsuar me sheqer apo me mjaltë, lëng portokalli, pije të gazuara...

**e saktë**

Larja e përditshme e dhëmbëve të fëmijës sim dhe të ushqyerit e tij të shëndetshëm më mbingarkojnë shpesh...

**e saktë**

Unë nuk i pastroj dhëmbët e mi ditëpërditë...

**e saktë**

Unë vetë shkoj tek mjeku/ mjekja i/e dhëmbëve vetëm nëse më dhembose më pengon dhëmbi...

**e saktë**

**Nëse keni kryqëzuar më shumë se një herë «e saktë» atëherë ekziston rreziku i shtuar i kariesit tek fëmija Juaj. Atëherë lëreni të këshilloheni tek mjeku/ mjekja Juaj i/e dhëmbëve.**